



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 549/2 Prot.

Vlorë më, 10 . 03 .2023

VENDIM
Nr. 11, datë 10.03.2023

PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE SHITESË
TË PRANIMIT NË PROGRAMIN E STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL
"UDHËRRËFYES TURISTIK PËR RAJONIN E JUGUT

Në mbështetje të nenit 38, nenit 74, 76,78 të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma f, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe referuar propozimit të Zv/Rektorit Akademik ardhur e shkresën nr.531/1 prot, datë 09.03.2023 Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 10.03.2023

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret shitesë të pranimit në programin e studimit me karakter profesional "Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut", në Departamentin e Gjuhëve të Huaja, si më poshtë:

Kritere shitesë:

Për t'u pranuar në program, studenti duhet të dëshmojë zotërim të nivelit B1 në gjuhën angleze sipas Kuadrit Evropian të Përbashkët të Referencave për Gjuhët. Për përcaktimin e nivelit të gjuhës angleze, studenti do t'i nënshtrohet një testimi (*placement test*), i cili do të përgatitet e administrohet nga komisioni *ad-hoc* i pranimit të kandidatëve aplikues, i ngritur nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja. Për gjuhën e dytë të huaj, niveli hyrës i njohjes së gjuhës nga studenti është nivel fillestar.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektor i Akademik, Drejtuesit e njësisë kryesore, Drejtorja e Ciklit të parë dhe të dytë të studimit.
3. Kriteret e miratuara i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

